



PLANI KOMBËTAR PËR ZVOGËLIMIN E EMISIONEVE

Kosovë

2018

Draft

Kosovë - Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve

Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve të ndotësve kryesorë nga impiantet me djegie të mëdha

Përmbajtja

1. Qëllimi i dokumentit.....	3
2. Fusha e zbatimit të PKZE-së	5
2.1. Impiantet që mund të marrin pjesë në PKZE.....	6
2.2. Impiantet që nuk mund të aplikojnë për pjesëmarrje në PKZE.....	6
3. Qasja ndaj rregullave përcaktuese që kufizojnë vlerat totale të emisioneve në vitin 2027...6	
4. Operimi i impianteve gjatë fazës së zbatimit të PKZE-së	7
5. Emisionet e vlerësuara dhe raportimi për PKZE-në	7
5.1. Vlerësimi dhe monitorimi i kufijve të emisioneve.....	8
5.2. Ndryshimet në PKZE.....	9
5.3. Raportimi tek Traktati i Komunitetit të Energjisë.....	9
6. Lista e masave që duhet të aplikohen në mënyrë që të sigurohet zbatimi i PKZE-së.....	10
7. Kufijtë e emisioneve totale dhe mjetet për arritjen e objektivave të përcaktuara në PKZE.....	12
8. Shtojcat e PKZE-së.....	14

Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve

1. Qëllimi i dokumentit

Dokumenti i referohet udhëzimeve për politika nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për sa i përket përgatitjes së Planeve Kombëtare për Zvogëlimin e Emisioneve: Në pajtim me Nenin 4 (3) të Direktivës 2001/80/EC ndërlidhur me pikën 3 të Shtojcës II të Traktatit të Komunitetit të Energjisë si dhe Nenin 3 të Vendimit D/2013/05/MC-EnC të Këshillit të Ministrave, nga Palët Kontraktuese kërkohet të arrijnë zvogëlime të konsiderueshme të emisioneve nga impiantet ekzistuese me djegie nga 1 janari i vitit 2018. Në Vendimin D/2013/05/MC-EnC, Këshilli i Ministrave iu dha mundësinë Palëve Kontraktuese që deri më 31 dhjetor 2027 ta përdorin si alternativë Planin Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve (PKZE) në përcaktimin e vlerave të kufirit të emisioneve të Direktivës 2001/80/EC për secilin impiant me djegie veç a veç.

Kosova është nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE) për Evropën Lindore, e cila ka hyrë në fuqi më 1 korrik 2006. Në këtë kontekst, Qeveria e Kosovës është angazhuar substancialisht në zhvillimin e sektorit të energjisë në përputhje me kërkesat e TKE-së, si krijim të një kornize rregullative dhe të tregut të qëndrueshëm që mund të stimulojë investimet në rrjetet e gazit, si dhe rrjetin e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Ky Traktat e bën të detyrueshme zbatimin e "Acquis Communautaire" të BE-së nga secila Palë Kontraktuese, bazuar në planin për zbatimin e reformave të kërkuara, veçanërisht të "Acquis Communautaire" për mjedisin përmes zbatimit të Direktivës 2001/80/EC për kufizimin e emisioneve të ndotësve të caktuar në ajër nga impiantet me djegie të mëdha (IDM). Në tetor të vitit 2013, Këshilli i Ministrave i Komunitetit të Energjisë, miratoi Vendimin për zbatimin e Direktivës për IDM, duke caktuar datat për procedurën e zbatimit të dispozitave individuale të përcaktuara në Direktivën (D/2013/05/MC-End). Në legjislacionin e Kosovës, Direktiva 2001/80/EC e transpozuar në ligjin kombëtar përmes Ligjit për PKIN dhe Udhëzimit Administrativ (UA) për Rregullat dhe Standardet e Ajrit nga Burimet Stacionare të Ndotjes.

Përgatitja e PKZE-së për Kosovën ka rëndësi thelbësore në përmbushjen e vlerave të kufirit të emisioneve për SO₂, NO_x dhe pluhur, përmes zvogëlimit gradual të emisioneve specifike dhe të sasisë së emisioneve të ndotësve, të shkarkuara nga impiantet me djegie të mëdha dhe ndërlidhet me synimet për zvogëlimin e emisioneve për impiantet ekzistuese me djegie me input termik optimal prej 50 MW ose më shumë.

PKZE-ja do ta specifikojë periudhën kohore për t'i përmbushur kërkesat e Direktivave 2010/75/EU për secilin impiant me djegie të përfshirë në këtë dokument, për dyoksidin e sulfurit (SO₂), oksidet e azotit (NO_x) dhe pluhurin. Për më tepër, PKZE-ja përfshinë kufijtë e emisioneve të përgjithshme vjetore të SO₂, NO_x dhe pluhurit.

Pas përgjigjes së SKE-së për sa i përket PKZE-së së parë të propozuar dhe kërkesës për përmbushjen e kërkesave të KE-së për të arritur zvogëlime të konsiderueshme të emisioneve nga impiantet ekzistuese me djegie prej më së largu 1 janarit 2018 e tutje, ky draft i përditësuar i PKZE-së është modifikuar në përputhje me kërkesat, duke marrë parasysh informacionin më të fundit në shkrim që është në dispozicion, e i cili përfshin jo vetëm të dhënat më të fundit të emisioneve por edhe informacionin teknik nga studimi i fisibilitetit për rehabilitimin e TC Kosova B.

Në mënyrë që të arrihen objektivat ambicioze në kornizën kohore të kërkuar, duhet të zbatohet një numër i veprimeve strategjike. Këto objektiva janë siç vijon:

- Njësitë aktuale operative A dhe B duhet të **përmirësohen teknikisht** në mënyrë që të jenë në pajtueshmëri me standardet e emisioneve. Kjo detyrë do të bazohet në rekomandimet e studimit të fizibilitetit për TC Kosova B dhe përvojën e projekteve të mëparshme të JICA-s në TC Kosova A (të cilat kanë rezultuar shumë të suksesshme dhe kanë ulur emisionet e pluhurit nën nivelin e Direktivës për IDM), por kjo nënkupton periudha të mirëmbajtjes të cilat do ta zvogëlojnë prodhimin e përgjithshëm.
- Për ta balancuar sistemin sipas këtij skenari, duhet të ndërmerren veprime në drejtim të:
 - o **rritjes së kapacitetit të gjenerimit të energjisë së ripërtëritshme** (në përputhje me trendin e viteve të fundit),
 - o **reduktimin e kërkesës për energji elektrike**, sa më shumë që të jetë e mundur, përmes zbatimit të masave të eficiencës së energjisë dhe ngritjes së vetëdijes.

Më në fund, pas analizimit të gjendjes aktuale dhe masave shtesë të inkuorporuara është hartuar një PKZE më ambicioz dhe më konsistente.

Pavarësisht nga ambicia e këtij Plani, është e rëndësishme të theksohen kufizimet në Kosovë që mund t'i pengojnë arritjet e objektivave në një afat kaq të shkurtër:

- Kosova është në proces të sigurimit të financimit për ta arritur zvogëlimin e emisioneve në ajër nga TC-të në përputhje me legjislacionin.
- Sistemi energjetik i Kosovës është subjekt i rreziqeve të mëdha të sigurisë për sa i përket furnizimit për përmbushjen e kërkesës për energji elektrike, në skenarin kur kërkesa nga shumica e konsumatorëve dhe sektorëve vazhdon të rritet.
- Vonesa në rindërtimin dhe zhvillimin e sektorit të prodhimit të energjisë elektrike, në përputhje me TKE EJL (ECT SEE).
- Vonesa në ndërtimin dhe fillimin e funksionimit të impiantit të ri Kosova e Re.

Ky dokument ofron kornizën e Planit Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve (PKZE) për t'i zvogëluar emisionet e ndotësve kryesorë nga impiantet me djegie të mëdha dhe ndërlidhet me zvogëlimin e emisioneve për impiantet ekzistuese me djegie me input termik optimal prej 50MW ose më shumë, të cilave u është dhënë leja për emisione para 31 dhjetorit të vitit 1992. Ky dokument specifikon kohën për përmbushjen e kërkesave të Direktivave 2010/75/EU1 për dyoksidin e sulfurit (SO₂), oksidet e azotit (NO_x) dhe pluhurin për secilin impiant me djegie të përfshirë në PKZE. Për operatorët që operojnë impiantet me djegie dhe grupet e tyre, PKZE-ja përfshinë kufijtë e emisioneve të përgjithshme vjetore për të paktën njërin nga SO₂, NO_x dhe pluhuri.

PKZE-ja e Kosovës përfshinë TC-të Kosova A dhe B për shkak se ato nuk kanë arritur t'i përmbushin kriteret e përcaktuara nga D/2001/80 EC në kohë të duhur, dhe për këtë arsye është vendosur të merret pjesë në këtë mekanizëm të përjashtimit nga pajtueshmëria e menjëhershme me vlerat e kufirit të emisioneve të Direktivës 2010/75/EU.

Njësitë A3, A4 dhe A5 të përfshira në PKZE kanë bërë investime të konsiderueshme për ta përmirësuar teknologjinë, që ka çuar në zvogëlimin e emisioneve me fokus të veçantë në pluhur.

Me përfundimin e PKZE-së, impiantet të cilat shfrytëzuan aplikimin e këtij mekanizmi të përjashtimit, duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet e emisioneve bazuar në parimet e përgjithshme të referuara në Direktivën 2010/75/EU.

2. Fusha e zbatimit të PKZE-së

Baza për zhvillimin e PKZE-së udhëhiqet nga parimet e Direktivës 2010/75/EU dhe Vendimi 2012/115/EU.

Gjatë periudhës 1990 deri 2015 janë përgatitur më shumë se 50 studime teknike, dokumente dhe raporte nga konsulentë të financuar nga donatorët nga bashkësia ndërkombëtare, duke u fokusuar në prodhimin e energjisë elektrike, ristrukturimin e sektorit të energjisë dhe çështjet ligjore mjedisore në sektorin e energjisë.

Konkluzionet dhe rekomandimet e këtyre studimeve janë prezantuar në Strategjinë e Energjisë së Kosovës 2009-2018.

- Ndërtimi i TC-së së re Kosova e Re
- Rehabilitimi i njërive të caktuara në TC-të ekzistuese deri sa të ndërtohen njësitë e para të TC Kosova e Re, dhe
- Zhvillimi i një miniere të re për furnizimin e TC Kosova A dhe B si dhe të TC Kosova e Re

- Kosova ka zhvilluar dhe po zbaton një numër të projekteve si pjesë të Programit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (EE) dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE). Kosova ka bërë shumë përpjekje në këtë drejtim dhe në mungesë të ligjit për Eficiencë të Energjisë ka promovuar një numër të akteve nënligjore legjislative që rregullojnë fusha të caktuara të EE-së dhe BRE-së. Këta janë disa shembuj të Legjislacionit nënligjor të miratuar: (i) Udhëzimi Administrativ për Etiketimin e Pajisjeve të Amvisërisë, (ii) Udhëzimi Administrativ për Auditimin e Energjisë, (iii) Udhëzimi Administrativ për Shfrytëzimin e Energjisë nga Konsumatorët Përfundimtarë, (iv) Udhëzimi Administrativ për Synimet Indikative Vjetore dhe Dhjetëvjeçare për BRE, dhe (v) Vendimi i Qeverisë për Stimulimet për Zhvillimin e BRE-së.

Një nga studimet e fundit që mund të përdoret si referencë për draft PKZE-në është "Studimi mbi Nevojën për Modernizimin e Impianteve me Djegie të Mëdha në Komunitetin e Energjisë" të përgatitur nga East European Consultants, Ltd. (Konsulentët e Evropës Juglindore, ShPK.), nëntor 2013.

2.1. Impiantet që mund të marrin pjesë në PKZE

Rregullat themelore mbi kushtet për pjesëmarrje në PKZE 2018 - 2027, janë paraqitur në vijim.

TC Kosova A dhe B janë impiante të identifikuara me input termik optimal prej më shumë se 50 MW, të cilat do të përfshihen në PKZE .

2.2. Impiantet që nuk mund të aplikojnë për pjesëmarrje në PKZE

Nuk ka impiante në këtë situatë në Kosovë.

2.3. Impiantet me djegie të cilat nuk janë mbuluar në 2.1 dhe 2.2

Nuk ka impiante në këtë situatë në Kosovë.

3. Qasja ndaj rregullave përcaktuese që kufizojnë vlerat totale të emisioneve në vitin 2027

Janë ndjekur Udhëzimet për Politika nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për përgatitjen e Planeve Kombëtare për Zvogëlimin e Emisioneve (PG 3/2014 të 19 dhjetorit 2014) dhe tabelat e nxjerra i janë bashkëngjitur këtij dokumenti duke siguruar informacionin përkatës (p.sh. impiantet e përfshira me kapacitet termik, shkalla e

rrjedhës mesatare vjetore të gazit të shkarkuar dhe sasia e lëndës djegëse e përdorur për periudhën 2008-2012, të dhënat e emisioneve për 2014, kontributet individuale në kufirin e emisioneve për vitet **2018, 2023, 2027**).

Shkalla e rrjedhës së gazit të shkarkuar është llogaritur duke marrë parasysh të dhënat e njohura për impiante (karakteristikat e lëndës djegëse, konsumi, orët e operimit etj.) dhe është ofruar dosja Excel me llogaritjet ("Impianti") .

Për çdo vit duke filluar nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2027, gjatë periudhës së planit, impiantet me djegie të përfshira në PKZE duhet ta sigurojnë uljen e emisioneve në emisionet bruto të ndotësit(ve) nga impiantet me djegie të mëdha në Kosovë si dhe duhet t'i përmbushin detyrimet për të qenë në pajtueshmëri me vlerat e kufirit të emisioneve siç është përcaktuar në Direktivën 2010/75/EU në termat e përcaktuar nga Plani.

4. Operimi i impianteve gjatë fazës së zbatimit të PKZE-së

Impiantet me djegie të mbuluara me PKZE nuk janë të detyruar t'i përmbushin vlerat e kufirit të emisioneve të përcaktuara në Direktivën 2010/75/EU (Pjesa I e Shtojcës V) gjatë fazës së zbatimit të PKZE, në baza secili impiant veç a veç.

Impiantet e mbuluara me PKZE duhet ta sigurojnë pajtueshmërinë e përgjithshme me emisionet maksimale vjetore të SO₂, NO_x dhe pluhurit në nivel kombëtar në përputhje me kufijtë e përcaktuar nga PKZE-ja, gjatë periudhës së zbatimit të tij (2018 deri **2027**).

Pjesëmarrja në PKZE nuk përjashton vazhdimin e operimit të impiantit pas përfundimit të periudhës së zbatimit të PKZE-së, me kusht që impianti i tillë të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e Direktivës 2010/75/EU për impiantet e reja siç është specifikuar në Pjesën II të Shtojcës së saj.

5. Emisionet e vlerësuara dhe raportimi për PKZE

5.1 Vlerësimi dhe monitorimi i emisioneve

Aty ku vlen, vlerësimi dhe monitorimi i emisioneve nga impiantet e mbuluara me PKZE duhet të bëhet bazuar në matjet e vazhdueshme siç kërkohet nga Direktiva 2010/75/EU. Në mungesë të këtyre matjeve, rregullat dhe plani i vlerësimit bëhen siç vijon:

- Llogaritja e përgjithshme e emisioneve vjetore të ndotësve kryhet në përputhje me llogaritjen e kufirit të emisioneve totale. Vëllimi i emisioneve llogaritet bazuar në sasinë e lëndës djegëse të djegur, sasinë e gazrave të emetuara të kanalit, të llogaritur në bazë të faktorëve të njëjtë si për llogaritjen e kufizimit të emisioneve dhe arritjen e

përqendrimeve aktuale mesatare të emisioneve. Për më tepër, përqendrimet aktuale përcaktohen për:

- për TC B, emisionet shumicën e kohës maten në baza të vazhdueshme,
- për TC A, emisionet e pluhurit maten në baza të vazhdueshme dhe emisionet e SO₂ dhe NO_x llogariten bazuar në përqendrimet mesatare mujore.
- Sasia e linjtit të djegur përcaktohet bazuar në raportet e konsumit të lëndës djegëse dhe cilësinë e tij ose në bazë të raporteve të emisioneve të CO₂ në vitin e caktuar.

Lëndët djegëse shtesë (mbështetëse) nuk merren parasysh në planin e llogaritjes së përgjithshme të emisioneve.

Verifikimi i sasisë së emisioneve kryhet çdo vit gjatë kohëzgjatjes së PKZE-së, duke krahasuar raportet e emisioneve nga operatori i impianteve me djegie bazuar në kufirin e emisioneve për operatorin.

Për t'i përmbushur detyrimet e tij nën kufizimin e emisioneve totale, operatori gjatë vitit mund ta bëjë shkëmbimin e sasisë së emisioneve ndërmjet TC-ve me kusht që niveli kombëtar bruto i emisioneve, siç është përcaktuar në PKZE, të mos tejkalohet.

5.2. Ndryshimet në PKZE

Pezullimi i operacionit ose mbyllja e përhershme e impiantit të mbuluar përmes PKZE-së ose përjashtimi i një impianti të tillë nuk duhet ta mundësojë rritjen në emisionet totale bruto vjetore. Në këtë rast, është i nevojshëm përditësimi i listës së impianteve të mbuluara me PKZE, e shoqëruar me përditësimin e kufijve të emisioneve për të gjithë ndotësit.

Kërkesa nga operatori për ta përfshirë një impiant me djegie në PKZE, nuk duhet ta përjashtojë mundësinë për ta hequr atë nga lista e impianteve më vonë pas dorëzimit të kushteve të përgjithshme për përdorimin e këtyre mekanizmave të përjashtimit. Impiantet me djegie në këtë rast duhet të nxirren jashtë nga PKZE-ja pasi që autoriteti kompetent të jetë njoftuar nga operatori i impiantit për vendimin e tij.

Vendimi për ta shfrytëzuar çfarëdo mekanizmi alternativ të përjashtimit përmes PKZE-së mund të merret në atë kohë kur PKZE-ja i nënshtrohet vlerësimit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Gjatë periudhës së zbatimit të PKZE-së, një impiant me djegie mund të nxirret jashtë nga PKZE-ja pas vendimit të operatorit. Gatishmëria për ta refuzuar pjesëmarrjen në PKZE duhet të raportohet në Ministrinë e Mjedisit para 1 qershorit të vitit para vitit kur impianti nuk dëshiron të marrë pjesë më në PKZE.

Dalja nga PKZE-ja do të thotë se operimi i impiantit do të jetë në përputhje me parimet e Direktivës 2010/75/EU dhe nga impianti do të kërkohet që të jetë në pajtueshmëri me vlerat e kufirit të emisioneve të Pjesës 1 së Shtojcës V të Direktivës 2010/75/EU.

Impianti që nxirret jashtë nga PKZE-ja nuk mund t'i ri-bashkohet PKZE-së.

Ndryshimi i operatorit të cilitdo impiant me djegie që merr pjesë në PKZE nuk e liron pronarin e ri nga detyrimet për ta respektuar PKZE-në për këtë impiant me djegie.

5.3. Raportimi tek Traktati i Komunitetit të Energjisë

Duhet të përpilohet raporti vjetor për zbatimin e PKZE-së dhe të dërgohet në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë brenda 12 muajve nga fundi i vitit që mbulohet nga raporti.

Raporti do të përmbajë:

- listën e impianteve pjesëmarrëse;
- krahasimin ndërmjet kufijve të emisioneve dhe emisioneve aktuale për atë vit;
- përshkrimin e çdo ndëshkimi të shqiptuar për impiantet që kanë dështuar t'i përmbushin detyrimet e veta;
- përshkrimin e çdo investimi të bërë në pajisjet e pastrimit të gazrave të kanalit në impiantet pjesëmarrëse;
- listën e impianteve të nxjerra jashtë nga PKZE-ja dhe arsyet e nxjerrjes jashtë;
- listën e të dhënave teknike të përditësuara dhe të kufijve të përditësuar për impiantet që mbesin në PKZE;
- përmbledhjen

6. Lista e masave që duhet të aplikohen në mënyrë që të sigurohet ekzekutimi i PKZE-së

Pas përfundimit të periudhës së zbatimit të PKZE-së, impiantet pjesëmarrëse në PKZE duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet e përcaktuara në Shtojcën V të Direktivës 2010/75/EU. Këto standarde do të transpozohen në legjislacionin e Kosovës përmes

amendamentimit të dispozitave për standardet e emisioneve për impiantet me djegie të mëdha.

Këto dispozita do t'i përshkruajnë:

1. Standardet për emisionet në ajër të gazrave ose pluhurit nga impiantet, që janë të ndryshueshme bazuar në llojin e aktivitetit, procesin teknologjik ose operimin teknik, datën e fillimit të operimit të impiantit, datën e mbylljes ose periudhën e mëtejme totale të operimit.
2. Situatat që justifikojnë përjashtime kalimtare nga standardet dhe kufijtë e përjashtimeve.
3. Kushtet për standardet e emisioneve të konsiderohet se janë përmbushur.
4. Kërkesat në lidhje me shfrytëzimin e zgjidhjeve teknike të veçanta për të siguruar që emisionet të zvogëlohen.
5. Procedurat në rast të ndërprerjes në proceset teknologjike ose operacionet teknike të ndërlidhura me operimin e impiantit.
6. Llojet e ndërprerjeve që kërkojnë mbylljen e impiantit.
7. Masat parandaluese që duhet të ndërmerren nga operatori i impiantit.
8. Rastet në të cilat operatori i impiantit duhet ta informojë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, afatin e fundit kohor për njoftimin e tillë dhe mënyrën në të cilën duhet të bëhet.

Derisa PKZE-ja të jetë në fuqi dhe pasi të ketë përfunduar, nga impiantet pjesëmarrëse do të kërkohet që të jenë në pajtueshmëri me të gjitha dispozitat e legjislacionit të Kosovës për mbrojtjen e mjedisit. Nga impiante të tilla gjithashtu do të kërkohet që të jenë në pajtueshmëri me kushtet e operimit të përcaktuara në lejet. Në përputhje me këto dispozita, lejet e integruara do të duhet t'i përfshijnë kushtet e detajuara të operimit për secilin impiant që merr pjesë në PKZE. Legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit përcakton rregulla të hollësishme për përgjegjësinë e operatorëve të impianteve që dështojnë të jenë në pajtueshmëri me kushtet e lejeve të integruara.

Nga impiante të tilla gjithashtu do të kërkohet që të jenë në pajtueshmëri me kushtet e operimit të përcaktuara në lejet për emisione. Në përputhje me këto dispozita, lejet për emisione do të duhet t'i përfshijnë kushtet e detajuara të operimit për secilin impiant që merr pjesë në PKZE. Legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit përcakton rregullat e detajuara për përgjegjësinë e operatorëve të impianteve që dështojnë të jenë në pajtueshmëri me kushtet e lejeve për emisione.

9. Secila palë që operon impiantin e që kërkon leje për emisione duhet të jetë në pajtueshmëri jo vetëm me kërkesat për emisione të përcaktuara në leje - dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit bazuar në Teknikat më të Mira në Dispozicion, si dhe standardet e cilësisë mjedisore - por edhe me standardet e emisioneve të përcaktuara në dispozitat e aplikueshme për standardet e emisioneve të impiantit. Prandaj këto kërkesa gjithashtu do të duhet të përmbushen nga impiantet që marrin pjesë në PKZE.

Dispozitat në fuqi përfshijnë rregulla specifike për përgjegjësinë në rast të mos-pajtueshmërisë me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit. Ekzistojnë tri lloje të ndryshme të përgjegjësisë - civile, penale dhe administrative. Format e përgjegjësisë në këtë fushë përcaktohen në veçanti në legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit. Për sa i përket përgjegjësisë administrative në lidhje me impiantet me djegie, dispozitat përfshijnë rregulla nën të cilat impianti mund të mbyllet dhe mund t'i shqiptohen gjoba, për shembull, për mos-pajtueshmëri me lejet e integruara në terma të sasive ose llojeve të gazrave ose pluhurit që liron në ajër. Këto gjoba i nënshtrohen të njëjtave procedura të zbatimit sikurse borxhet tatimore.

Procedurat për nxjerrjen e vendimeve të tilla nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mund të fillojnë nga inspektorët e mjedisit.

Prandaj, masat e lartpërmendura do të mund të aplikohen për të gjitha impiantet me djegie të mbuluara nga PKZE-ja, në mënyrë që të sigurohet se më së voni deri më 31 dhjetor 2027 këto impiante janë në pajtueshmëri me vlerat e kufirit të emisioneve siç është përcaktuar në Shtojcën V të Direktivës 2010/75/EU. Në Kosovë, kontrolli i pajtueshmërisë me kërkesat mjedisore, duke përfshirë kushtet e përcaktuara në lejet e integruara, i është besuar inspektimit mjedisor të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

7. Kufijtë e emisioneve totale dhe mjetet për arritjen e objektivave të përcaktuara në PKZE

Zbatimi i PKZE-së do të çojë në zvogëlim të konsiderueshëm në emisionet e dyoksidit të sulfurit, oksideve të azotit dhe pluhurit për grupin e të gjithë impianteve pjesëmarrëse. Zbatimi i objektivave aktuale të PKZE-së dhe objektivit kryesor, përkatësisht përshtatja e impianteve sipas kërkesave të Direktivës 2010/75/EU është kombinim i monitorimit të kontrollit dhe masave teknike që përfshijnë rehabilitimin e impianteve me djegie (që përfshinë projektimin dhe instalimin e pajisjeve për ndotës specifike, siç janë njësitë e desulfurizimit, flakadanët me NOx të ulët dhe Fundërruesit Elektrostatik).

Në këtë rast me projektin për rehabilitimin e TC Kosova B (e financuar nga BE-ja dhe Buxheti i Kosovës:

1- Për NOx

- DEI do të zbatohet në TC Kosova B1 në vitin 2021
- DEI do të zbatohet në TC Kosova B2 në vitin 2022

- në TC Kosova A, optimizimi i procesit të djegies në kaldaja, me zvogëlimin e ajrit parazit dhe me uljen e temperaturës së kaldajës për ta zvogëluar sa më shumë që është e mundur prodhimin e NOx

2- Për Pluhur

- DEI do të zbatohet në TC Kosova B1 në vitin 2021
- DEI do të zbatohet në TC Kosova B2 në vitin 2022

Tabela 1 paraqet pasqyrën e kufijve të emisioneve për të gjithë pjesëmarrësit në PKZE për periudhat **2018-2027** (Tabela B.3 në Vendimin 2012/115/EU).

Ndotësit	2014	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Pluhuri ton/vit	15,175	5,255	3,993	3,302	1,556	883	885	475	475	475	475
SOx ton/vit	12,746	12,757	11,112	10,150	10,111	11,077	11,125	9,497	9,497	9,497	6,129
NOx ton/vit	21,412	21,176	13,890	10,239	8,948	8,829	5,563	6,129	6,129	6,129	6,129

Tabela 1. Kufijtë e emisioneve të kombinuara [Mg] për impiantet me djegie në Kosovë që janë pjesëmarrëse në PKZE

8. Shtojcat e PKZE-së

Shtojca 1 - Efektet mjedisore të zbatimit të PKZE-së

Shtojca 2 - Kufijtë e emisionit [Mg] për emisionet totale të ndotësve për operatorët e impianteve me djegie të mëdha

Shtojca 3 - Lista e impianteve me djegie të mëdha në Kosovë

Shtojca 4 - Lista e impianteve me djegie të mëdha në Kosovë të mbuluara me Planin Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve

SHTOJCA 1

Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve

Efektet mjedisore të zbatimit të PKZE-së

Në grafikët e mëposhtëm paraqitet trendi i zvogëlimit të emisioneve bruto të ndotësve gjatë zbatimit të PKZE-së. Ky dokument tregon zvogëlim të madh në fund të vitit **2027** krahasuar me emisionet e vitit 2018. Vlera e emisioneve totale në vitin **2027** bazohet në pajtueshmërinë me kërkesat e Direktivës 2010/75/EU. Si rezultat i futjes në përdorim të teknologjive të thëngjillit të pastër në sektorin e energjisë në Kosovë, planifikohet që të zvogëlohen në nivel të konsiderueshëm emisionet e dyoksidit të sulfurit (Figura 1).

Vlera e emisioneve totale deri në fund të vitit **2027** do të llogaritet bazuar në vlerat e kufirit të emisioneve nga Direktiva 2010/75/EU dhe parashikimi i prodhimit dhe kapaciteti i instaluar i sistemit energjetik të Kosovës, bazuar në Strategjinë e Energjisë.




Figura 1. Dinamika e zvogëlimit të emisioneve bruto të SO₂

Figura 2. tregon vlerat e kufirit të emisioneve të oksideve të azotit për të gjitha impiantet me djegie në Kosovë për periudhën e kohëzgjatjes së PKZE-së.




Figura 2. Vlerat e kufirit të emisioneve totale të NO_x për impiantet me djegie të mëdha.




Figura 3. Vlerat e kufirit të emisioneve totale të pluhurit për impiantet me djegie të mëdha në Kosovë.

SHTOJCA 2

Kufijtë e emisionit [Mg] të emisioneve totale të ndotësve për operatorët e impianteve me djegie të mëdha. shih fig. 1

Kufijtë e emisioneve janë dhënë në dosjen Excel të bashkëngjitur ("kufijtë e PKZE-së 2022 të Kosovës 20160427"). Në këtë dosje janë listuar impiantet e përfshira në PKZE dhe është llogaritur kontributi i tyre individual në kufijtë e emisioneve.

SHTOJCA 3

Lista e impianteve me djegie të mëdha në Kosovë

Numri	Emri i Impiantit	Lokacioni	Operatori	Viti i Hyrjes në Funksion	Shkalla totale e inputit termik më 31.12.2012 (MW)	Numri vjetor i orëve të punës (mesatarja 2008 - 2012)	Emisionet e SO ₂ 2012	Emisionet e NO _x 2012	Emisionet e Pluhurit 2012
							t	t	t
1	TC Kosova A3	Obiliq	KEK	1970	200	5331	2138.6	2226.9	1820.3
2	TC Kosova A4	Obiliq	KEK	1971	200	4693	3356	4088	3162
3	TC Kosova A5	Obiliq	KEK	1975	210	3964	3186	3719	1564
4	TC Kosova B	Obiliq	KEK	1984	339x2	6925	9218.5	12616.3	5577.8

SHTOJCA 4

Informacioni bazë - që rregullon legjislacionin e BE-së

Baza për zhvillimin e PKZE-së udhëhiqet nga Neni 32 i Direktivës 2010/75/EU dhe nga Vendimi 2012/115/EU

Ky dokument është kompletuar me shënime/informacione bazuar në këto dokumente:

1. Udhëzimet për t'i ndihmuar Palët Kontraktuese në përgatitjen e Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve (Komuniteti i Energjisë)
2. Dispozitat e Nenit 4 (6) të Direktivës 2001/80/EC për kufizimin e emisioneve të ndotësve të caktuar në ajër nga impiantet me djegie të mëdha siç është përshtatur përmes Nenit 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave D/2013/05/MC-EnC
3. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2009-2018
4. Parashikimi i kërkesës për Energji dhe mbulimi i saj për periudhën 2009-2018 (Kosovë)